

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, Departamenti I Pergjithshem – Divizioni Civil, Gjyqtari Skender Shala, ne qeshtjen juridike te paditesve dhe qe te dy nga Mitrovica, te cilet sipas autorizimit me shkrim i perfaqson Av. nga Mitrovica, kunder te paditurve dhe qe te nga Mitrovica, tani me vendbanim te panjohur, te cilen e perfaqeson perfaqesuesi i perkohshem avokati Kapllan Baruti nga Mitrovica, sipas aktvendimit te kesaj gjykate, dhe nga Mitrovica te cilet sipas autorizimit me shkrim i perfaqson Av. nga Mitrovica dhe Komuna e Mitrovices, te cilen e perfaqeson Avokati per vertetim pronsie, vlera e kontestit 1.000 Euro, pas mbajtjes se shqyrtimit kryesor dhe publik, te dt. 12.06.2015, bie kete:

AKT GJYKIM

I – VERTETOHET se paditesit dhe nga Mitrovica jane pronar i objektit banesor ne siperfaqe prej **S=95,68m²** si dhe iu ipet e drejta e shfrytzimit te perhershem ne paluajtshmerine dhe ate: pjeses se ngastres katastrale nr.**3018-2**, ne siperfaqe prej **S=27m²**, me kulture are e klases se dyte, ne vendin e quajtur “Tavnik” me masat dhe kufijte qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes , pjeses se ngastres katastrale nr.**3020-6**, ne siperfaqe prej **S=73m²**, me kulture are e klases se dyte, ne vendin e quajtur “Tavnik” me masat dhe kufijte qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes, pjeses se ngastres katastrale nr. **3021-1**, ne siperfaqe prej **S=322m²**, me kulture oborr, ne vendin e quajtur “Tavnik” me masat dhe kufijte qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes, ne te cilat eshte ndertuar objekti banesor, per perdorim dhe shfrytezim te rregullt te objektit banesor, te cilat evidentohen ne emer te te paditures P.SH. Kuvendi Komunal Mitrovice 1/1, ZK Mitrovice dhe pjeses se ngastres katastrale nr.**3020-1**, ne siperfaqe prej **S=7m²**, me kulture are e klases se dyte, ne vendin e quajtur “Tavnik” me masat dhe kufijte qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes, e cila evidentohet ne emer te te paditurve

ZK Mitrovice.

II – OBLIGOHEN te paditurit qe t’ia njohin kete te drejte paditesve, ne afatin prej 15 (pesembedhjet) diteve, nga dita e pranimit te ketij aktgjykimi.

OBLIGOHEN paditesit qe t’ia kompenzojne shpenzimet perfaqesuesit te perkohshem av. nga Mitrovica Shumen 472.5 euro, ne afat prej 15 diteve nga dita e pranimit te ketij aktgjykimit, nen kercnim te permbarimit te dhunshem.

Secila pale i barte shpenzimet e tjera te procedures kontestimore.

Arsyetim

Paditesit ne padin e tyre te parashtruar dhe permes te autorizuarit te tyre ne seancat e mbajtura kane theksuar se qysh ne vitin 1967 ne baze te kontrates me shkrim, kane blere parcelen ne vendin e quajtur " nga I padituri I dyte me çmim prej 80.850,00 dinare te atehershem, ne sipërfaqe rreth afer 7 ari te cilin qmim ia kane paguar ne teresi shitesit dhe se prej atij momenti kane hyre ne shfrytezim dhe posedim te papenguar dhe te panderprer e gjer me tani, ne te cilen nderton shtepi familjare, andaj ka interes juridik qe te vertetohet se ai eshte pronar i pjeses te kesaj paluejtshmerie.

I autorizuari i paditsve ne seancen e shqyrtimit kryesor dhe ne fjalen perfundimtare deklaroi se Mbetem ne teresi prane padise dhe kerkespadise se parashtruar dhe te precizuar sipa ekspertizes se ekspertit gjeodet dhe propozoj qe e njehta te aprovohet si e bazuua sepse qysh nga viti 1965 babai I paditesve actual ka ndertuar shtepi te S= 95,68 m2 dhe ne te edhe sot jetojne pasardhesit.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi.

Perfaqesuesi I perkoheshem i te paditurve ne seancen e shqyrtimit kryesor dhe ne fjalen e tij perfundimtare deklaroi se mbetet prane deklaratave te dhena me keto plotesime. Me administrimin e provave material dhe atyre formal-juridike te nxjerrura ne kete shqyrtim gjyqsor , propozoj qe gjykata te vendos ne baze te rrezultatave te provave.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk I kerkoi .

I autorizuari i te paditurve ne seancen e shqyrtimit kryesor dhe ne fjalen e tij perfundimtare deklaroi se perkitazi me kater te paditurit e tjere , e bazuar ne provat e adminstruara te cilat nuk kontestohen fare as nga presonat te cilit I perfaqesoj une nuk e kontestoj fare padine e as kerkespadine.

Shpenzimet i kerkoi TA-se .

Perfaqesuesi I te paditures Komuna e Mitrovices ne seancen e shqyrtimit kryesor dhe ne fjalen e tij perfundimtare deklaroi se mbetet ne teresi nga thenjet nga seancat paraprake.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesor, zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pas administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nenit 8 te LPK-es, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi: cartifikatat e pronesise me nr.te lendes 12-9948 te dt.16.03.2015 ZK Mitrovice ne emer te te paditures P.SH Kuveni komunal ne Mitrovice, 12-9947 te dt. 16.03.2015 ZK Mitrovice ne emer te te paditures P.SH Kuveni komunal ne Mitrovice dhe nr. 12-9949 te dt. 16.03.2015 ne emer te te paditurve dhe kontraten mbi shitblerjen e dt. 08.03.1961, procesverbalin mbi vendeshiqimin te kesaj gjykate

C.nr. 1403/2009 dt. 10.09.2014, ekspertizen gjeodete ne emer te ekspertit gjeodet Fehmi Doroci dt.16.03.2015 dhe plotesimi I te njejtes I dt.11.06.2015, beri veshtrim skicen e terenit dhe ne kopjen e planit te te njejtit ekspert gjeodet, degjoi deshmitaret dhe qe te dy nga Mitrovica dhe konstatoi kete gjendje faktike:

Nga Certifikatat mbi te drejtat e prones se paluajtshme te cekura me lart, konstatohet se pjeset e parcelave katastrale nr.3021-1, 3020-1,3018-2 dhe 3020-6, evidentohen ne emer te te paditurve.

Nga kontrata mbi shitblerjen e dt. 08.03.1961 vertetohet fakti se I padituri I dyte e ka blere nga I padituri I pare parcelen katastrale nr.3021-1 ne sipërfaqe prej 775m² dhe ia pagoi Shumen e kontraktuar prej 80.850.00 dinar te athershem dhe te njejten e vulosi ne Zyren e vertetimeve prane KK ne Mitrovice.

Nga procesverbali mbi vendeshiqimin te kesaj gjykate te cekur me larte, konstatohet se gjyqtari me vrojtim te drejtperdrejt ne vende dhe sipas deklarates se ekspertit konstatoi se paluajtshmerija eshte e kufizuar ne anen lindore me rruget e karakterit dytesor ne anen veriore, jugore dhe perendimore me prone private. Paluejtshmeria eshte e rrethuar me mur prej bllokave te betonit, ne te eshte te ndertuar nje shtepi e vitit 2004 e ndertuar ne themelet e shtepsie se vjeter e vitit 1965. Ne hyrje te oborrit jane te vendosura dyert prej metali te cilat I sherbajn paditesit per te hyre ne shtepit e tij.

Nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit gjeodet te cekur me lart, konstatohet se pas matjeve te kryera ne pjeset e parcelave kontestuese nga ana e ekspertit gjeodet dhe ne baze te dokumentacionit, me te cilin posedon per momentin Drejtoria e Gjeodezise dhe Katastrit ne Mitrovice, ka vertetuar se pjeset e aluajtshmerise kontestuese bien – gjegjesisht e perbejne pjeset e parcelve te cekura me larte me masa dhe kufij te shenuara si ne ekspertizen e dhene me shkrime dhe plotsimit te saj dhe skicen e terenit, e cila eshte pjese perberse e kesaj ekspertize dhe te aprovuar si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Deshmitari . deklaroi se ai personalisht e di se babai I paditesve me emrin ' e ka blere paluajtshmerine prej nje shitesit emri nuk me kujtohet ne vitin 1968 kur une kam ardhur nga fshati ai ka qene I vendosur ne ate shtepi e sipas disa gojdhaneve te fqinjëve dikund rreth vitit 1961, ne sipërfaqe prej diku afersisht 7 ari, me qmim te shitblerjes te cilin nuk jam I sigurt se sa e kane blere por e di se ate emim e ka paguar ne afat te caktuar dhe ate per tere paluajtshmerin edhe e cila edhe sot ekziston. Me rastin e shtiblerjes palet jane marrur vesh me mirekuptim por nuk e di se a kane nenshkruar ndonji kontrate me shkrim. E di se ne vitin 1968 ajo paluajtshmeri ka qene e rrethuar me rrethoj prej drrasave. E di dhe jam I sigurt se prej viti 1968 paditesit asnjeher nuk kane pasur kurrfarpengesash nga askush me posedimin dhe shfrytezimin e asaj paluajtshmerie kurse sic e ceka me larte ata kane hy ne ate posedim te asaj paluajtshmeri qysh nga viti 1968. Du ate potenciaj se pas lufte paditesit kane ndertuar shtepi te re ne themelet e shtepise se vjeter nga se shtepia e vjeter ishte shum e demtuar nga viti 1999 gjat lufte. Keto rrethana nga se une qysh nga viti 1968 jetoj ne fqinjesi me te paditesit.

Deshmitari I deklaroi se ai peronalisht e din se babai I paditesve me emrin I qe nga viti 1965 kur ne jemi vendosur ne shtepi ne ate lagje ai ka qene duke banuar ne ate vend ne nje shtepi njekateshe me bahce prepare dhe ka qene e rrethuar me taraba prej druri, ndersa prej kujt e ka blere dhe me cfare cmimi a i aka paguar te hollat dhe a kane perpiluar ndonji kontrate per shitblerje une nuk kam te dhena dhe nuk me kujtohet se ka qene dicka diskutabile kjo ceshtje , siperfaqja e paluajtshmerise eshte prej diku afersisht 5 ari, me gjithë shtepi. E di se paditesit kane ndertuar nje shtepi te re po ne themelet e shtepise se vjeter, viti nuk me kujtohet sepse une kah ajo rruge kaloj shume rralle. Per sa e di une nuk kam degjuar se dikush ta kete cek prej fqinjëve se tani paditesit kane pasur ndonjeher e sidomos prej viti 1965 ndonji pengese nga dikush ne posedimin dhe shfrytezimin e asaj paluajtshmerie. Tani ajo paluajtshmeri eshte e rrethuar prej muri. Keto rrethana I kam te njohura sic e ceka me larte nga viti 1965 jetoj ne ate lagje me nje pauz prej 9 viteve por prap jetoj ne ate lagje.

Nga nje gjendje te ketille faktike te cekur me larte, gjykata konstatoi se paditesit e fituan te drejten e pronesise ne parcelat e lartcekuraara te cilat jane objekt shqyrtimi dhe ne objektin banesor te ndertuar ne ato parcela, ne baze te kontrates me shkrim mbi shitblerjen e lidhur ne mes te te paditurit te dyte dhe te paditurit te pare te dt. 08.03.1961. Ndersa shitesit - i padituri i dyte ia kishte shitur babait te tani paditesve kete patundeshmeri, e i cili e kishte pasur ne posedim dhe shfrytezim shum vite me pare, duke e shfrytezuar kete patundeshmeri me gjate se 20 vite, e tani paditesit, kohe kjo e parapare per fitimin e te drejtes se prones ne baze te ndertimit ne token e huaj , e cekur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi, konform dispozites se nenit 24 te Ligjit mbi Marredheniet Themelore Juridike - Pronesore, pasi qe e paditura nuk ka kundershuar veprimet e paditesit perkitazi me ndertimin, edhe pse ka pasur dijeni per ndertimin e shtepise, nga se shtepija ne ate paluajtshmeri ka qene e ndertuar qysh ne vitet e 60- ta , kurse paditsi ka ndertuar shtepi ne themelet e shtepise se vjeter ne vitin 2004.

Paditesit te drejten e pronesise ne kete patundeshmeri e kane fituar edhe konform nenit 73 te Ligjit per Marredheniet Detyrimore pasiqe kontraten gojore te lidhur ne mes babait te tyre dhe shitesit - paditurit te dyte Tafil Nura e kishte permbushur ne teresi, pasiqe e kishte paguar cmimin kontraktues dhe poashtu kishte hyr ne pronesi dhe shfrytezim te kesaj patundeshmerie menjijher pas blerjes se te njejtes duke mos qene i penguar nga askush e te cilen edhe sot e shfrytezojne pasardhesit - tani ketu paditsit. Poashtu ne kontekstin e provave te larte cekura, gjykata ne baze te proves se vendshiqimit, konstatoj se paditesit edhe tani e tutje e kane ne posedim dhe shfrytzim kete paluajtshmeri, ne vijimsi te konsiderates se te njejten e kane ne posedim te vetin te fituar me shitblerje dhe me mbajtje me mirebesim.

Kete gjendje te tille faktike gjykata e vertetoi ne baze te deshmive te deshmitareve Rame Peci dhe Enver Preteni qe te dy nga Mitrovica, te cileve ua fali besimin e plote, pasiqe te njejtat ishin bindese dhe ne harmoni me kerkespadine.

Gjykata ne kete rast i aplikoi dispozitat e LMTHJP, nga se raporti juridik konkret i qeshtjes kontestimore eshte sajuar ne kohen kur ne aplikim ka qene ligji i lartcekur.

Vendimi mbi shpenzimet e perfaqesuesit te perkohshem u bazua ne dispoziten e nenit 453. 2 te LPK-se duke i njohur shpenzimet per pjesemarrje te perfaqesuesit te perkohshem dhe ate per tri seanca te mbajtura shumen prej nga 135 euro dhe per nje seance te shtyer shumen prej 67.5 euro, e konform nenit 7 te TA.

Vendimin qe secila pale ti barte shpenzimet e tjera te procedures kontestimore, bazohet konform nenit 459.1 te LPK-se.

Nga arsyet e cekura me lart u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICES
C.nr.142/2009, dt.12.06.2015.

Gjyqtari,
Skender Shala

KESHILLE JURIDIKE: Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar anekesa, ne afat prej 15 (pesembedhjet) diteve, nga dita e pranimit. Gjykates se Apelit ne Prishtine, e permes kesaj gjykate.

Saktesine e pershkrimt e verteton: